Mali i Zi / Crna Gora
Komuna e Tuzit / Opština Tuzi
Kryetari i Komunës
Predsjednik Opštine
Nr./Br. 01-307/26-9996/1

Rruga Tuz nr. 1 , nr. 44
Ulica Tuzi br.1 , br. 44
+382 20 **875 167**
kryetari@tuzi.org.me
Tuz – Tuzi, 27.11.2026. godine

Në bazë të nenit 30, paragrafit 1 të Ligjit për rimëkëmbjen pas fatkeqësive („Fletorja Zyrtare e Malit të Zi“, nr. 2/26), Rregullores për metodologjinë unike për vlerësimin e dëmeve, humbjeve dhe nevojave nga fatkeqësitë („Fletorja Zyrtare e Malit të Zi“, nr. 92/26) dhe Vendimit për formimin e Komisionit për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore, numër 01-041/26-1914/1, të datës 20 mars 2026, Komisioni për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore i Komunës së Tuzit shpall:

THIRRJE PUBLIKE
për paraqitjen e kërkesave për dëmet, humbjet dhe nevojat e shkaktuara si pasojë e erërave të stuhishme dhe përmbytjeve

I
Ftohen qytetarët, shoqëritë tregtare, sipërmarrësit dhe bartësit e ekonomive bujqësore, të cilët kanë pësuar dëme në territorin e Komunës së Tuzit, të paraqesin dëmet, humbjet dhe nevojat e shkaktuara si pasojë e erërave të stuhishme dhe përmbytjeve që kanë përfshirë territorin e komunës në periudhën nga 19 deri më 27 nëntor 2026.
Kërkesat kanë të bëjnë veçanërisht me dëmet dhe humbjet e shkaktuara në:

- objektet e banimit, objektet ndihmëse dhe afariste;
- objektet bujqësore, mekanizimin, pajisjet, serrat plastike dhe serrat prej qelqi;
- kulturat bujqësore dhe plantacionet shumëvjeçare;
- pasurinë e luajtshme dhe infrastrukturën;
- të mirat e tjera të përfshira në metodologjinë unike për vlerësimin e dëmeve, humbjeve dhe nevojave nga fatkeqësitë.

Paraqitësit e kërkesave mund të deklarojnë gjithashtu humbjet ekonomike të pësuara, si dhe nevojat për sanim dhe rimëkëmbje.

II
Afati për paraqitjen e kërkesave fillon nga dita e publikimit të kësaj thirrjeje publike dhe përfundon më **14 dhjetor 2026, përfshirë edhe këtë datë.**
Në raste të jashtëzakonshme, kërkesat mund të paraqiten edhe pas skadimit të afatit të lartpërmendur, sipas kushteve të përcaktuara me Ligjin për rimëkëmbjen pas fatkeqësive.

III
Kërkesës duhet t'i bashkëngjitet dokumentacioni i mëposhtëm:

- formulari i plotësuar për paraqitjen e dëmeve, humbjeve dhe nevojave, i cili është në dispozicion në faqen zyrtare të internetit të Komunës së Tuzit;
- fotokopja e letërnjoftimit të paraqitësit të kërkesës për personat fizikë, përkatësisht ekstrakti nga Regjistri Qendror i Subjekteve Ekonomike (CRPS) për personat juridikë dhe sipërmarrësit;
- dëshmia e pronësisë, e së drejtës së shfrytëzimit ose e një baze tjetër juridike për shfrytëzimin e pasurisë së dëmtuar (fleta e pasurisë së paluajtshme, kontrata e qirasë, vendimi për regjistrim në Regjistrin e Ekonomive Bujqësore etj.);
- fotografitë e dëmtimeve të shkaktuara, nëse paraqitësi i kërkesës i posedon ato;
- dokumentacioni tjetër në dispozicion, me rëndësi për përcaktimin e dëmeve, humbjeve dhe nevojave të shkaktuara.

Të dhënat nga evidencat zyrtare do të sigurohen sipas detyrës zyrtare, në përputhje me ligjin.

IV

Kërkesat me dokumentacionin e nevojshëm dorëzohen në zarf të mbyllur, drejtpërdrejt në arkivin e Komunës së Tuzit, çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në orën 15:00, ose nëpërmjet postës në adresën:

Komuna e Tuzit – Komisioni për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore

Me shënimin: „Paraqitja e dëmeve, humbjeve dhe nevojave të shkaktuara si pasojë e erërave të stuhishme dhe përmbytjeve".

Me kërkesat e paraqitura jashtë afatit dhe me kërkesat e paplota do të veprohet në përputhje me Ligjin për rimëkëmbjen pas fatkeqësive dhe aktet e tjera normative në fuqi.

V

Komisioni do të kryejë vlerësimin e dëmeve, humbjeve dhe nevojave të paraqitura, në përputhje me Ligjin për rimëkëmbjen pas fatkeqësive dhe Rregulloren për metodologjinë unike për vlerësimin e dëmeve, humbjeve dhe nevojave nga fatkeqësitë.

Paraqitësit e kërkesave janë të detyruar t'i mundësojnë Komisionit qasje në pasurinë e dëmtuar, me qëllim të konstatimit të gjendjes faktike dhe vlerësimit të dëmeve të shkaktuara.

Paraqitësve të kërkesave u rekomandohet që, deri në daljen e Komisionit në terren, të mos kryejnë sanimin e dëmtimeve në mënyrë që do ta pamundësonte konstatimin e gjendjes faktike, përveç rasteve kur ndërhyrja urgjente është e domosdoshme për parandalimin e dëmeve të mëtejshme ose për mbrojtjen e jetës, shëndetit dhe sigurisë së njerëzve dhe të pasurisë.

Në rast të ndërhyrjes së domosdoshme urgjente, paraqitësve të kërkesave u rekomandohet që, nëse është e mundur dhe e sigurt, paraprakisht t'i dokumentojnë dëmtimet e shkaktuara me fotografi ose në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme.

Paraqitja e kërkesës dhe kryerja e vlerësimit nuk nënkuptojnë automatikisht realizimin e së drejtës për ndihmë dhe as kompensimin e dëmit në shumën e plotë.

VI

Kjo thirrje publike do të publikohet në faqen zyrtare të internetit dhe në tabelën e shpalljeve të Komunës së Tuzit, si dhe nëpërmjet mjeteve të informimit publik.

KOMISIONI PËR VLERËSIMIN E DËMEVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE